



KONTRATË KONCESIONI

E FORMËS “BOT” (NDËRTIM - OPERIM - TRANSFERIM)

**PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN,
PRONESINE, SHFRYTEZIMIN, MIREMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E KASKADES SE HIDROCENTRALEVE
NE LUMIN E SHALES,
REPUBLIKA E SHQIPERISE**

ndermjet

**MINISTRISE SE EKONOMISE, TREGETISE DHE
ENERGJITIKES**

dhe

**Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive
“INTERENERGO ALBANIA” sh.p.k, “POTEZA SKUPINA” d.d.
and “SGP POMGRAD” d.d.”**

28 PRILL 2008

KONTRATE KONCESIONI
E FORMES "BOT" (NDERTIM - OPERIM - TRANSFERIM)
PER
PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDERTIMIN, PRONESINE, SHFRYTEZIMIN,
MIREMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TE KASKADES SE
HIDROCENTRALEVE
NE LUMIN SHALE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

E lidhur ne Tirane, me date 28 prill 2009 (dy mije e nente), ndermjet paleve te meposhtme:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, qe me poshte do te quhet **"AUTORITETI KONTRAKTUES"**, percaktuar si i tille me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 757, date 07.11.2007, "Per percaktimin e Autoritetit Kontraktues per dhenien me koncension te hidrocentraleve "Dukagjini 1, Dukagjini 2 dhe Dukagjini 3" perfaqesuar nga Z. Kristo Rodi, i autorizuar rregullisht nga Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, Z. Genc Ruli, sipas autorizimit nr. _____, date _____

DHE

Bashkimi i perkohshem i shoqerive "INTERENERGO", i krijuar nga shoqerite **INTERENERGO ALBANIA Shpk.**, **POTEZA SKUPINA d.d.** dhe **SGP POMGRAD d.d.**, qe ne vijim do te quhet **"KONÇESIONARI"**, sipas marreveshjes se konsorciumit, pergatitur nga noter Agim Xh. Robo, me nr. 625 Kol, nr. 4249 Rep, date 18.04.2008 me keto te dhena:

Shoqeria **"INTERENERGO ALBANIA Shpk."** regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 38266, date 10.05.2007, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane;

Shoqeria **"POTEZA SKUPINA d.d."** regjistruar si person juridik me numer identifikimi 5817641, date 01.12.1993, te Gjykates se Rrethit Ljubljane, Slloveni.

KONTRATE KONCESIONI "BOT"

Shoqeria "**SGP POMGRAD d.d.**", regjistruar si person juridik me numer identifikimi 5459001, date 20.02.1991, te Gjykates se Rrethit Murska Sobota, Slloveni.

Shoqeria "**INTERENERGO ALBANIA Shpk.**", e percaktuar si shoqeri kryesuese, perfaqesohet nga Z. Anton Papež, shtetas slloven, i autorizuar rregullisht nga administratoret e shoqerise "**INTERENERGO ALBANIA Shpk.**" me prokuren nr. 2836 rep., nr, 375 kol., date 28.04.2009 (hartuar nga noter Agim Xh. Robo).

HYRJE

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Shqiperise:

1. I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj ose rehabilitimit te hidrocentraleve ekzistues me ane te procedurave te koncesionit, per permiresimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrjetit elektrik kombetar;
2. Konsideron ndertimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikës se zhvillimit te sektorit te energjise.
3. Vlereson formen "BOT" te koncesionit, si nje forme koncesioni qe ben te mundur nxitjen e investitoreve private per ndertimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat;
4. Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit;
5. Mirepret investoret vendas ose te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike.

Koncesionari:

1. Ka kryer fillimisht studimin teknik, ekonomik dhe mjedisor per ndertimin dhe operimin e tre hidrocentraleve ne lumin Shale te quajtur "Dukagjini 1",

"Dukagjini 2" dhe "Dukagjini 3", si nje propozim i pakerkuar. Nepermjet Vendimit nr. 757, date 07.11.2007 "Per percaktimin e Autoritetit Kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentraleve "Dukagjini 1", "Dukagjini 2" dhe "Dukagjini 3", Keshilli i Ministrave vendosi te filloje procedurat konkurruese per projektin e e propozuar nga Koncesionari.

2. Ne perputhje me ligjin nr. 9663, date 18.12.2006 "Per koncesionet", vendimin nr. 757, date 07.11.2007, Njoftimin e Kontrates dhe Udhezimeve per Kandiduesit, Autoriteti Kontraktues ftoi pjesemarrjesit te paraqisnin ofertat e tyre per shfrytezimin e te gjithë lumit Shale, pa kufizuar numrin e hidrocentraleve qe do te ndertoheshin.
3. Ne vijim te perfundimit te studimeve te metejshme mbi aspektet ekonomike, teknike dhe mjedisore te ndertimit dhe shfrytezimit te kaskades se hidrocentraleve ne lumin Shale, Koncesionari ka paraqitur oferten e tij me date 22.04.2008, duke propozuar ndertimin e 6 (gjashte) hidrocentraleve ne lumin Shale dhe ne perfundim te procedures perzgjedhese konkurruese eshte vleresuar si ofertuesi me i mire.
4. Eshte i interesuar te investoje ne ndertimin e hidrocentraleve perkates ne perroin e lumit Shale, ne rrethin e Shkodres, me qellim prodhimin e energjise elektrike dhe rritjen e sigurise te furnizimit me energji elektrike te zones;
5. **Bashkimi i perkohshem i shoqerive "INTERENERGO"**, nepermjet anetareve te saj, zoteron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, per te realizuar projektin e miratuar sipas objektit te kesaj Kontrate;
6. Zoteron aftesite drejtuese, financiare dhe teknike te kerkuara si dhe aftesite per te plotesuar kete iniciative ne perputhje me standardet nderkombetare.

Palet lidhin kete Kontrate koncesioni bazuar ne ligjin nr. 9663, date 18.12.2006 "Per koncesionet" i ndryshuar dhe ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 757, date 07.11.2007 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentraleve "Dukagjini 1", "Dukagjini 2" dhe "Dukagjini 3" dhe bien dakord per sa me poshte:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Perkufizime dhe interpretime

1. Kudo qe ne kete Kontrate perdoren termat e meposhtme, ato do te kene kuptimet perkatese si vijon:
 - 1.1. **"Kontrata e Koncesionit"**: Kjo Kontrate, anekset dhe çdo dokument tjetër qe do te bashkelidhet me te si pjese perberese dhe e pandare.
 - 1.2. **"Ligji "Per Koncesionet"**: Ligji nr. 9663, date 18.12.2006 "Per koncesionet", i ndryshuar.
 - 1.3. **"Autoriteti Kontraktues"**: Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, qe vepron ne emer dhe per llogari te Keshillit te Ministrave sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 757, date 07.11.2007 "Per percaktimin e Autoritetit Kontraktues per dhenien me koncension te hidrocentraleve "Dukagjini 1", "Dukagjini 2" dhe "Dukagjini 3".
 - 1.4. **"Koncesionari"**: Bashkimi i perkohshem i shoqerive i quajtur "INTERENERGO", i perbere nga anetaret: "INTERENERGO ALBANIA Shpk.", "POTEZA SKUPINA d.d" dhe "SGP POMGRAD d.d", me seli ne adresen: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla II, Kati 11, Tirane.
 - 1.5. **Hidrocentralet**: Kaskada e hidrocentraleve me vendndodhje ne rrjedhen e lumit Shale, rrethi Shkoder, me fuqi te instaluar 127.600 (njqind e njezet e shtate mije e gjashte qind) kW dhe prodhim te energjise elektrike rreth 530.350.000 (peseqind e tridhjete milion e treqind e pesedhjete mije) kWh, i perbere nga teresia e objekteve qe sherbejne per prodhimin e energjise elektrike duke perfshire por pa u kufizuar ne: digen, vepren e marrjes, kanal in e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin qe dergon ujin ne turbina, lidhjen me sistemin, ndertesen e centralit se bashku me makinerite dhe pajisjet e intaluara ne te.
 - 1.6. **"Objekti"**: Financimi, projektimi, ndertimi, venia ne pune, administrimi, mirembajta e kaskades se hidrocentraleve dhe transferimi i tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
 - 1.7. **"Projekti"**: (i) projektimi, financimi, ndertimi, pronesia, shfrytezimi, mirembajtja dhe transferimi i pronesise se hidrocentraleve ne lumin Shale

tek Autoriteti Kontraktues dhe (ii) zgjerimi i Objekteve Ekzistuese (nese ka), pronesia e Objekteve Ekzistuese te zgjeruara (nese zgjerohen) dhe mirembajtja e te gjithë Objekteve Ekzistuese.

- 1.8. **"Investimi"**: Vlera totale ne Euro qe do te sherbeje per ndertimin dhe pajisjen me makinerite e nevojshme te hidrocentraleve, deri ne fillimin e prodhimit te energjise elektrike me vlere 18.876.907.000 (tetembedhjete miliard e teteqind e shtatedhjete e gjashte milion e nenteqind e shtate mije) Leke, e cila duke patur parasysh luhatjet e kursit te kembimit nga data e skadences se vlefshmerise se ofertes se tenderit do te kete vleren ne Euro ne shumen 144.606.305 (njeqind e dyzet e kater milion e gjashteqind e gjashte mije e treqind e pese), prej te cilave 8.368.983.000 (tete miliard e treqind e gjashtedhjete e tete milion e nenteqind e tetedhjete e tre mije) Leke, qe duke patur parasysh luhatjet e kursit te kembimit nga data e skadences se vlefshmerise se ofertes se tenderit do te kete vleren ne Euro ne shumen 64.110.487 (gjashtedhjete e kater milion e njeqind e dhjete mije e katerqind e tetedhjete e shtate) do te investohen ne makineri dhe pajisje.
- 1.9. **"Punimet"**: Teresia e veprimeve per projektimin inxhinierik, ndertimin dhe venien ne pune te kaskades se hidrocentraleve ne lumin Shale, ne perputhje me projektin e zbatimit, duke perfshire te gjitha punimet civile te nevojshme dhe instalimet elektro-mekanike, qe perfshin por pa u kufizuar vetem tek turbinat, gjeneratoren, pajisjet ndihmese per ndertesën e centralit, transformatoren, pajisjet e nenstacionit dhe linjat e transmetimit tek Pika e Levrimet me rrjetin elektrik shqiptar .
- 1.10. **"Pika e Levrimet"**: pika per te cilen Koncesionari ka rene dakord me OST (Operatori Sistemit te Transmetimit) qe gjendet ne anen e tensionit te larte te transformatorit rrites ose te nenstacionit ne pronesi te Koncesionarit dhe te pajisjeve te rrjetit te transmetimit ne pronesi (ose qe do te jene ne pronesi) te OST ne perputhje me Ligjin "Per sektorin e energjise" dhe nepermjet te ciles Prodhimi Neto i Energjise Elektrike kalon nga kontrolli dhe risku i Koncesionarit tek rrjeti i transmetimit.
- 1.11. **"OST"** do te thote shoqeria OST Sh.A., e cila eshte operatori i sistemit te transmetimit per rrjetin elektro-energetik kombetar te Shqiperise.
- 1.12. **"Fillimi i punimeve"**: Zbatimi i projektit pas miratimit te tij sipas nenit 8.2 te kesaj Kontrate.
- 1.13. **"Venja ne pune e hidrocentraleve"**: Fillimi i prodhimit te energjise elektrike pas testimit sipas nenit 11 te kesaj Kontrate.
- 1.14. **"Kontratat"**: Te gjitha kontratat e nenshkruara nga Koncesionari, me sipermarresit per realizimin e punimeve dhe çdo marreveshje tjeter e

lidhur me te tretet qe ka si objekt operimin e hidrocentraleve dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.

- 1.15. **"Leje dhe Liçenca"**: Akte administrative, qe leshohen nga autoritetet perkates publike per te bere te mundur ushtrimin e veprimtarise sipas objektit te kesaj Kontrate, bazuar ne legjislacionin ne fuqi, ne veçanti te gjitha lejet, autorizimet, liçencat dhe miratimet e ERE (Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike) per ndertimin, instalimin dhe/ose mirembajtjen, te kerkuar per zbatimin dhe permbushjen e kesaj Kontrate.
- 1.16. **"Operimi"**: Te gjitha veprimet e Koncesionarit per prodhimin, furnizimin, transmetimin, shperndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjise elektrike, ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate.
- 1.17. **"Tarifa koncesionare"**: Sasia vjetore e energjise elektrike e shprehur ne perqindje, qe i jepet pa pagese Autoritetit Kontraktues.
- 1.18. **"Llogaritja e afateve"**: Kur afati eshte caktuar me dite, perjashtohet dita ne te cilen ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet te filloje afati. Afati qe eshte caktuar ne muaj ose ne vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike te javes se fundit ose te muajit te fundit qe ka te njejtin emer ose numer me ate te dites numerike qe ka filluar afati. Kur nje dite e tille mungon ne muajin e fundit afati mbaron me kalimin e dites se fundit te ketij muaji. Kur dita e fundit e nje afati bie ne dite pushimi, afati mbaron ne ditën e punes, qe vjen pas asaj te pushimit.
- 1.19. **"Data Efektive"**: nenkupton datën e hyrjes ne fuqi te vendimit te Keshillit te Ministrave qe miraton kete Kontrate, sipas percaktimeve te ligjit nr. 9663, date 18.12.2006 "Per koncesionet", te ndryshuar.
- 1.20. **"Subjekti i furnizimit me energji elektrike"**: Personi i liçencuar per tregtimin me shumice ose furnizimin publik te energjise elektrike ne baze te legjislacionit shqiptar.
- 1.21. **"Sigurimi i kontrates"**: Vlera monetare e ngurtesuar ne nje llogari te posaçme ose ne nje shoqeri sigurimesh ose garanci bankare e kerkueshme menjehere e leshuar nga nje banke kryesore nderkombetare dhe me reputacion qe preferohet te kete aktivitet edhe ne Shqiperi (nepermjet nje filiali ose dege), me qellim qe te garantoje Autoritetin Kontraktues ne rastet e shkeljes se Kontrates nga Koncesionari, sipas Nenit 14.
- 1.22. **"Ligj"**: Nenkupton çdo ligj organik, dekret, vendim te Keshillit te Ministrave ose çdo ligj tjeter qe shpallet si i tille, rregullore, udhezim, urdher, license, leje, autorizim ose çdo akt tjeter ligjor i shpallur nga Republika e Shqiperise, vendime gjyqesore qe kane karakter unifikues, akte zyrtare te leshuara nga çdo organ qendror dhe/ose vendor, ashtu siç mund te ndryshojne gjate kohezgjatjes se kesaj Kontrate.

- 1.23. **"Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike (ERE)":** Eshte institucioni rregullator i sektorit te energjise elektrike qe vepron sipas Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003, i ndryshuar.
- 1.24. **"Aneks":** Çdo deklarate, vertetim, autorizim, vendim, urdher ose dokument tjetër i nenshkruar nga palet qe i bashkelidhet kesaj Kontrate, si pjese perberese dhe e pandare e saj, tani apo ne te ardhmen.
- 1.25. **"Instrument Financiar":** Nenkupton çdo marreveshje huaje, kredie, marreveshje siguruese ose çdo instrument tjetër i perdorur nga Koncesionari ne lidhje me financimin e objektit te ketij koncesioni, duke perfshire çdo ndryshim, shtese, rinovim apo zevendesim te secilit prej ketyre instrumenteve.
- 1.26. **"Pala Financuese":** Nenkupton çdo person ose persona qe japin kredi per financime ose rifinancime ne formen e kontratave te huamarrjes, bonove, obligacioneve, marreveshjeve te sigurimit/dorezane, deklaratave te regjistrimit ose informimit, marreveshjeve te varesise, hipotekave, akteve te perfaqesimit dhe administrimit, marreveshjeve te kredise, marreveshjeve per blerjen e bonove ose obligacioneve, marreveshjeve te pjesemarrjes dhe dokumentave te tjera, ndaj Shoqerise Koncesionare ne lidhje me projektimin, prokurimin, ndertimin, shfrytezimin dhe mirembajtjen e objektit te koncesionit dhe per ushtrimin e te drejtave koncesionare, si dhe zevendesuesit dhe te ngarkuarit e lejuar te ketyre personave, duke perfshire çdo agjent ose perfaqesues per nje person ose persona te tille dhe duke perfshire nje aksionar ose nje filial te nje aksionari, qe do te ndihmoje Koncesionarin ne financimin e objektit te koncesionit.
- 1.27. **"E Drejta per Kalim"** do te thote e drejta per te kaluar mbi, midis, ne, prej dhe nen Shesh, dhe ne çdo pjese te tij, si dhe per te hyre dhe per te dale ne te, pa nderhyrje te parregullt nga ndonje pale e trete, me qellim zbatimin e kesaj Kontrate gjate Periudhes se Koncesionit.
- 1.28. **"Shesh"** do te thote sheshi qe gjendet rreth lumit Shale, qe perfshin te gjithë siperfaqen, godinat, rruget lidhese dhe objektet e tjera qe lidhen me hidrocentralet si dhe objektin e kesaj Kontrate, ne perputhje me termat e references te percaktuara ne Dokumentat Standarde te Tenderit.
- 1.29. **"Gezim i qete"** do te thote e drejta ekskluzive per te zene, perdorur dhe gezuar Sheshin (duke perfshire Objektet Ekzistuese), ujin e lumit Shale dhe te Drejten per Kalim gjate Periudhes se Koncesionit, ne perputhje me kete Kontrate, pa nderhyrje te parregullt nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonje entitet tjetër shteteror.

- 1.30. **"Faj"**: Faji i Koncesionarit ose Shoqerise Koncesionare nenkupton çdo veprim ose mosveprim te Koncesionarit ose Shoqerise Koncesionare me dashje ose nga pakujdesia, si rezultat i te cileve Koncesionari nuk permbush detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate. Per te shmangur çdo keqkuptim, mospermbushja e detyrimeve si rezultat i fakteve, veprimeve, ose mosveprimeve qe jane pertej kontrollit te Koncesionarit, siç jane rrethanat e permendura ne nenin 20.1, duke perfshire kryerjen e rinovimeve/mirembajtjeve te hidrocentraleve gjate periudhave kohore te paracaktuara rregullisht, nuk do te konsiderohen si mospermbushje me faj te Koncesionarit per efekt te zbatimit te kesaj Kontrate dhe veçanerisht nenit 23.2.
- 1.31. **"Praktika e Industrise se Mire"**: praktikat, metodat, standartet, procedurat dhe rekomandimet qe jane ne perputhje me Ligjet e zbatuara pergjithesisht ne industrine e prodhimit te energjise hidroelektrike persa i perket projektimit, ndertimit, shfrytezimit dhe mirembajtjes se energjise hidroelektrike, e cila pritet ne menyre te arsyeshme te realizohet nga nje kontraktor i afte dhe me eksperience, inxhinier ose operator, sipas rastit, ne rrethana te njejta ose te ngjashme; praktika, metoda, standarde dhe procedura te cilat do te perfshijne, pa kufizim, standartet Shqiptare dhe Evropiane (cilado qofshin me te larta, nga nje periudhe kohore ne tjetren).
- 1.32. **"Veprim Shteteror Thelbesisht ne Kundershtim me Marreveshjen"**: çdo veprim ose mosveprim qe ndodh pas dates se nenshkrimit te kesaj Kontrate, nga ana e nje organi qeveritar dhe/ose publik, qe perben nje Veprim Shteteror Thelbesisht ne Kundershtim me kete Kontrate nenkupton rrethanat e meposhtme:
- (i) Mospajisje e Autorizimeve (duke perfshire edhe Lejet dhe Licensat) te nevojshem per Koncesionarin per qellim te permbushjes se rregullt te detyrimeve te tij dhe te zbatimit te te drejtave te tij sipas kesaj Kontrate, me kusht qe Koncesionari te kete permbushur te gjitha detyrimet e tij;
 - (ii) shpronesimi, marrja, konfiskimi ose shtetezimi i hidrocentraleve dhe/ose te Drejtave Koncesionare; dhe
 - (iii) ndalimi ose kufizimi i riatdhesimit ose transferimit te fitimeve ose te te ardhurave te Koncesionarit dhe detyrimeve/borxheve (te justifikuara me Dokumente Financiare) nga Republika e Shqiperise (duke perfshire ndalimin dhe kufizimet ne kembimin e monedhave te huaja);
- 1.33 **"Filial"**: Shoqeri, e cila eshte e zoteruar ose e kontrolluar nga Koncesionari ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte ose nga ndonjeri prej

anetareve te Koncesionarit ose nga shoqeri te zoteruara apo te kontrolluara prej tyre.

2. Perveçse kur permbajtja parashikon ndryshe, ne kete Kontrate:

2.1. Njejesi e perfshin shumetin dhe anasjelltas;

2.2. Referimi tek njera gjini perfshin edhe gjinine tjeter dhe gjinine asnjane;

2.3. Çdo fraze qe fillon me fjale "duke perfshire", "perfshin", "ne veçanti", "per shembull", te tilla si apo te ngjashme, do te kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj pergjithshmerise se fjaleve te pergjithshme te lidhura;

2.4. Titujt e perdorur per nenet, paragrafet, nenparagrafet, Anekset dhe tabela e permbajtjes jane vetem per lehtësi referimi dhe nuk do te ndikojne ne interpretimin e kesaj Kontrate;

2.5. Referimet ne dispozitat dhe Anekset jane, perveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kesaj Kontrate.

2.6. Pa paragjykim ndaj paragrafit te mesiperem, nese ka ndonje konflikt apo mosperputhje ndermjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonje shtojce te Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjeter qe i referohemi ne kete Kontrate, konflikti apo mosperputhja do te zgjidhet sipas rendit te meposhtem te perparemise:

2.6.1. Kerkesat e Autoritetit Kontraktues ne proceduren konkurruese;

2.6.2. Oferta e Koncesionarit;

2.6.3. Dispozitat e kesaj Kontrate;

2.6.4. Çdo Aneks tjeter dhe shtojcat e tyre;

2.6.5. Çdo dokument tjeter qe i referohemi ne kete Kontrate ose çdo dokument tjeter bashkelidhur kesaj Kontrate.

Neni 2

Objekti i Koncesionit

Me ane te kesaj Kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise ne baze te ligjit "Per koncesionet", i jep Koncesionarit me koncesion te formes BOT (qe do te thote ndertim, operim dhe transferim i se drejtes se pronesise dhe operimit ne perfundim te Kontrates se koncesionit):

Financimin, projektimin, planifikimin, ndertimin, testimin, kolaudimin, venien ne pune, pronesine, administrimin, mirembajtjen e kaskades se hidrocentraleve ne lumin Shale dhe transferimin e tyre ne perfundim te Kontrates nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate.

Neni 3

Karakteristikat e kaskades se hidrocentraleve ne lumin Shale

3.1. Kaskada e hidrocentraleve ne lumin Shale do te ndertohet ne perroin e lumit Shale, rrethi i Shkodres, me keto karakteristika:

- Kuota maksimale e rrjedhes se lumit 834 m mbi nivelin e detit
(kuota e marrjes se ujit tek hidrocentrali i pare i kaskades)
- Kuota minimale e rrjedhjes se lumit 165 m mbi nivelin e detit
(kuota e godines se hidrocentralit te fundit te kaskades)
- Totali i fuqise se instaluar 127.600 kW
- Prodhimi vjetor mesatar i energjise elektrike 530.350.000 kWh
- Numri i hidrocentraleve jo me shume se 6 hidrocentrale

Neni 4

Periudha e Koncesionit

4.1. Koncesioni jepet per nje periudhe prej 35 (tridhjetepese) vjetesh nga Data Efektive dhe perfundon ne ditën e pervjetorit te 35-te te Dates Efektive ("Periudha Efektive"). Megjithate, ne rast se kjo Kontrate zgjidhet perpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do te nenkuptoje dhe do te kufizohet tek periudha qe fillon nga Data Efektive dhe mbaron ne Daten e Zgjidhjes.

4.2. Rastet e zgjatjes se Periudhes se Koncesionit:

- i. Palet bien dakord qe per shkaqe qe ndikojne drejtperdrejt ne Projekt (jo te shkaktuara nga Koncesionari) ku perfshihet vetem Forca Madhore, Periudha e Koncesionit do te zgjatet ne perputhje me kohen qe do t'i nevojitet projektit qe te konsiderohet si rentabel dhe financiarisht i pershtatshem ne perputhje me analizat financiare te "Vleres per Para", "IRR" apo çdo lloj analize tjetere te pershtatshme per vleresime te tilla.
- ii. Palet bien dakord qe Periudha e Koncesionit do te zgjatet ne rastin e nje Ngjarjeje te Forces Madhore, per nje periudhe kohe te barabarte me kohen qe ka zgjatur Ngjarja e Forces Madhore dhe kohen e arsyeshme qe nevojitet per riparimin e demeve te shkaktuara, me kusht qe vete Ngjarja te kete zgjatur per nje periudhe kohe mbi 1 (nje) muaj.
- iii. Ne rast mosperputhje midis pikave te siperpermendura (i) dhe (ii), Periudha e Koncesionit do te zgjatet ne funksion te klauzoles me favorizuese per Koncesionarin.

KREU II

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Te drejtat koncesionare - Sheshi

5.1. Dhenia e te Drejtave Koncesionare

Duke filluar nga Data Efektive, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili pranon, te drejtat ekskluzive per te gjithë Periudhen e Koncesionit per te kryer sa me poshte vijon:

- i. te projektoje, financoje, ndertoje, testojte, te kete ne pronesi, te operoje dhe te mirembaje Hidrocentralet;
- ii. t'i zgjeroje e shtojte Objektet Ekzistuese, nese ka, te kete ne pronesi pjeset e Objekteve Ekzistuese te zgjeruara a te shtuara, kur eshte e mundur te beje veçimin e ketyre pjeseve ne perputhje me Ligjin dhe te shfrytetoje dhe mirembaje Objektet Ekzistuese;
- iii. ne varesi te Nenit 5.2 me poshte, te kete Gezim te Qete;

- iv. t'i ktheje serish Autoritetit Kontraktues perdorimin e Sheshit dhe te Drejten per Kalim dhe t'i transferoje Autoritetit pronesine e Hidrocentraleve dhe te Objekteve Ekzistuese te shtuara, kur eshte e mundur, ne perfundim te Periudhes se Koncesionit, si dhe ne çdo rast, te kryeje ato veprime, te cilat jane pazgjdhmerisht te lidhura me keto aktivitete (se bashku te quajtur "**te Drejttat Koncesionare**"); dhe
- v. Koncesionari do te kete te drejten ekskluzive ndaj çdo atributi mjedisor qe mund te gjenerohet nga Projekti, duke perfshire por duke mos u kufizuar ne çertifikatat CER sipas Mekanizmave te Zhvillimit te Pastertise (*Clean Development Mechanism*) te percaktuara ne Protokollin e Kyoto.
- vi. Autoriteti Kontraktues do te mbeshtese çdo aplikim qe mund te dorezohet nga Koncesionari tek autoritetet perkatese ne lidhje me Mekanizmat e Zhvillimit te Pastertise (*Clean Development Mechanism*) dhe veçanerisht ne lidhje me marrjen e miratimit nga Ministria e Mjedisit, ne cilesine e autoritetit kombetar te caktuar (DNA) (me kusht qe Autoriteti Kontraktues te mos mbahet pergjegjes ne rast te mosmarrjes se ketij miratimi).

5.2. Dhenia e Sheshit

Pavaresisht nga sa parashikohet ne Nenin 5.1 me siper, Sheshi, e Drejta per Kalim, Gezimi i Qete do te konsiderohen se i jepen Koncesionarit vetem pasi Koncesionari te pajise Autoritetin Kontraktues me kopje te njehsuara me originalin te çertifikatave te sigurimit qe vertetojne (ne nje mase te arsyeshme te kenaqshme per Autoritetin Kontraktues) se Koncesionari eshte pajisur me policat e sigurimit dhe garancite e kerkuara per kete qellim ne perputhje me nenin 15 te kesaj Kontrate. Ne momentin e dorezimit te ketyre kopjeve, Koncesionari do te konsiderohet uzufruktar mbi Sheshin. Autoriteti Kontraktues do te ndermarre te gjitha masat e nevojshme per te krijuar dhe regjistruar te drejten e uzufruktit mbi Sheshin.

Ne lidhje me dhenien e Sheshit, te Drejten per Kalim, Gezimin e Qete dhe te drejten per akses dhe per te perdorur ujin e lumit Shala, Koncesionari e pranon Sheshin "siç eshte" qe nga data e kesaj dhenieje, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do te kryeje ndonje shpenzim, as nuk do te jete pergjegjes per ndonje pretendim perkundrejt Koncesionarit, ne lidhje me gjendjen e Sheshit.

Pavaresisht nga sa me siper, ne rast se per dhenien e Sheshit do te konsiderohet i nevojshem shpronnesimi i truallit qe eshte prone private, atehere Koncesionari do t'i paraqese Autoritetit Kontraktues te gjitha dokumentet dhe informacionet e nevojshme per procedurat e shpronnesimit ne lidhje me Sheshin, te cilat do te gjykohen te nevojshme nga Koncesionari dhe ne marreveshje me Autoritetin Kontraktues, duke perfshire edhe identifikimin e sakte te parcelave qe do te shpronnesohen.

Autoriteti Kontraktues do te miratoje propozimet per shpronnesim dhe do te ndjeke procedurat e shpronnesimit sipas dispozitave ligjore perkatese, me kusht qe te gjitha kostot dhe shpenzimet qe lidhen me sa me siper te perballohen nga Koncesionari.

Per te shmangur çdo keqkuptim, (i) çdo parcele e shpronnesuar ne perputhje me sa me siper do te konsiderohet e trupezuar me kete Shesh (duke e perfshire edhe per qellime te Gezimit te Qete) qe nga data e perfundimit te ketij shpronnesimi; (ii) data e paraqitur si date e kerkeses nga Koncesionari do te jete data ne te cilen Koncesionari ka paraqitur rregullisht te gjitha dokumentet e nevojshme per shpronnesim siç parashikohet ne ligj; (iii) Autoriteti Kontraktues ose enti shteteror perkates do te marre vendimin lidhur me shpronnesimin brenda afateve kohore te parashikuara ne perputhje me ligjin.

Ne rast se Autoriteti Kontraktues, pas paraqitjes se nje kerkeses per shpronnesim nga Koncesionari, nuk e miraton ate ne perputhje me kete nen ose nuk ndjek procedurat perkatese ne perputhje me ligjin, Koncesionari ka te drejten e demshperblimit per te gjitha demet ose shpenzimet e tjera qe lidhen me kete mospermbushje te Autoritetit Kontraktues, duke perfshire por pa u kufizuar vetem tek te drejtat qe rrjedhin nga Veprimet Shteterore Thelbesisht ne Kundershtim me Marreveshjen.

Neni 6

Monitorimi dhe Mbikqyrja e Pergjithshme

6.1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues ka te drejte qe ne periudha kohore prej 3 muajsh, gjate Periudhes se Konçesionit, nepermjet personave te autorizuar prej tij dhe ne prani te Koncesionarit, te monitoroje objektin e koncesionit, pas nje njoftimi paraprak te arsyeshem ndaj Koncesionarit, per te verifikuar permbushjen e

detyrimeve qe rrjedhin nga Kontrata ne te gjitha fazat e zbatimit te saj, me kusht qe ky monitorim te mos shkaktoje ndonje pengese te paarsyeshme, te nderhyje ne zhvillimin e ndertimit ose te nderprese ndertimin ose fazen operative, padrejtesisht.

Megjithate, Autoriteti Kontraktues mund te ushtroje kete monitorim ne çdo kohe, me kusht qe Autoriteti Kontraktues te disponoje informacione te arsyeshme dhe te besueshme ne lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve te kesaj Kontrate.

6.2. Mbikqyrja e pergjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues ka te drejte te ushtroje mbikqyrje te pergjithshme çdo tre muaj, gjate realizimit dhe funksionimit te Hidrocentraleve, nepermjet personave te autorizuar prej tij dhe ne prani te Koncesionarit, me synim qe te verifikoje se ecuria e punimeve, cilesia dhe konformiteti te jene ne perputhje me programin e pergjithshem te realizimit dhe te dokumentacionit te projektit. Autoriteti Kontraktues duhet t'i beje Koncesionarit nje njoftim paraprak te arsyeshem. Ne çdo rast, mbikqyrja nuk duhet te shkaktoje ndonje pengese te paarsyeshme, te nderhyje ne zhvillimin e ndertimit ose te nderprese ndertimin padrejtesisht.

Ne rast se gjate monitorimit dhe mbikqyrjes se pergjithshme konstatohen shkelje te Kontrates, Koncesionari do te njoftohet me shkrim per masat qe do te merren dhe detyrat e tij, si dhe menyren dhe afatet e zbatimit te tyre.

6.3 Kostot dhe procesverbalet e monitorimit dhe mbikqyrjes

Autoriteti Kontraktues do te marre persiper kostot e monitorimit dhe mbikqyrjes se ndertimit. Rezultatet e monitorimit dhe mbikqyrjes do te hartohen me shkrim dhe do te nenshkruhen nga te dyja palet. Ne rast se Autoriteti Kontraktues konstaton se Koncesionari ka shkelur kete Kontrate, procesverbali per monitorimin dhe mbikqyrjen duhet te permbaje edhe masat qe Koncesionari duhet te ndermarre dhe detyrimet qe duhen permbushur, si dhe menyren dhe afatet e kesaj permbushje.

Neni 7

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr persiper veçanerisht detyrimet e mëposhtme:

- 7.1. Te siguroje vazhdimesine e kesaj Kontrate pavaresisht ndryshimeve te objektivave te Sektorit Elektroenergetik Shqiptar.
- 7.2. Autoriteti Kontraktues me kerkese te Koncesionarit merr persiper te beje te gjitha perpjekjet e mundshme te percaktuara ne ligj, per te ndihmuar kete te fundit prane organeve shteterore ne lidhje me çdo pengese qe mund te haset ne kuader te pajisjes me leje, licensa, autorizime apo çdo lloj tjetër leje qe nevojitet per ekzekutimin e punimeve dhe operimin e Hidrocentraleve. Ky parashikim nuk eshte i zbatueshem kur mospajisja me leje, license, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospermbushjes se kerkesave ligjore perkatese nga Koncesionari.
- 7.3. Te miratoje Projektin e Zbatimit te hidrocentraleve, te pergatitur nga Koncesionari, ne perputhje me propozimin per te cilin eshte shpallur fitues ne proceduren e gares, duke lejuar ndryshime ne projekt te cilat nuk perbejne devijime te karakteristikave te kaskades se hidrocentraleve ne lumin Shale sipas percaktimeve te nenit 3.
- 7.4. Te beje perpjekjet me te mira per te ndihmuar Koncesionarin ne kuader te marredhenieve dhe lidhjes se marreveshjeve/kontratave me institucione publike per qellime te realizimit te objektit te kesaj Kontrate.
- 7.5. Te garantoje, nese kerkohet nga Koncesionari, detyrimin e Subjektit te Furnizimit te Energjise Elektrike per te blere te gjithë ose pjese te energjise elektrike te prodhuar nga Hidrocentralet, permes nje Marreveshje afatgjate per Shitjen e Energjise, kohezgjatja e se ciles nuk do te kaloje afatin prej 15 vjetesh, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne rast se kerkohet nga Koncesionari, Marreveshja per Shitjen e Energjise do te lidhet per Hidrocentralet me derivacion:

- (i) per Hidrocentralet me nje kapacitet te instaluar deri ne 15 MW: per te gjithë energjine e prodhuar nga keto Hidrocentrale;
- (ii) per Hidrocentralet me nje kapacitet te instaluar mbi 15 MW: per energjine e prodhuar deri ne 15 MW. Per te shmangur çdo keqkuptim, Koncesionari ka te drejte te disponoje lirisht energjine e prodhuar qe tejkalon 15 MW.

Marreveshja per Shitjen e Energjise do te lidhet per nje periudhe qe nuk do te zgjase me shume se 15 vjet, respektivisht dhe do te perfundoje ne pervjetorin e 15-te te nenshkrimt te Marreveshjes per Shitjen e Energjise, perkatesisht per secilin nga Hidrocentralet.

7.6. Te garantoje Koncesionarin qe ndertimi i veprave te tjera hidroteknike nuk do te ndikojë ne mbarevajtjen e projektit te Koncesionarit.

7.7. Autoriteti Kontraktues eshte pergjegjes per detyrimet ligjore dhe kontraktore ne rast te mospermbushjes se ketyre detyrimeve nga ana e tij duke shperblyer te gjitha demet e shkaktuara Koncesionarit per shkak te shkeljes se kushteve te percaktuara ne Kontraten e Koncesionit.

7.8. Autoriteti Kontraktues do te mbeshtese çdo aplikim qe mund te dorezohet nga Koncesionari tek autoritetet perkatese ne lidhje me Mekanizmat e Zhvillimit te Pastertise (*Clean Development Mechanism*) dhe veçanerisht ne lidhje me marrjen e miratimit nga Ministria e Mjedisit, ne cilesine e autoritetit kombetar te caktuar (DNA) (me kusht qe Autoriteti Kontraktues te mos mbahet pergjegjes ne rast te mosmarrjes se ketij miratimi).

KREU III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Neni 8 Detyrimet e Koncesionarit

8.1. Koncesionari eshte i detyruar te zbatoje Projektin dhe objektin e Kontrates konform kushteve te saj.

Veçanerisht Koncesionari duhet qe:

Te themeloje brenda 60 (gjashtedhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontrates së Koncesionit, shoqëri koncesionare, që do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

Me krijimin e shoqërisë së re koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me këtë Kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek shoqëria koncesionare duke filluar që nga data e regjistrimit të shoqërisë koncesionare në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Koncesionari dhe shoqëria e re koncesionare do të jenë solidarisht dhe veçmas përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.

Koncesionari do të dëmshperblejë Autoritetin Kontraktues në lidhje me çdo dëm, kosto, shpenzim ose përgjegjësi të cilat lidhen ose rrjedhin nga pakujdesia ose mospermbushja e detyrimeve sipas kësaj Kontrate. Anasjelltas, Autoriteti Kontraktues do të dëmshperblejë Koncesionarin në lidhje me çdo dëm, kosto, shpenzim ose përgjegjësi të cilat lidhen dhe rrjedhin nga pakujdesia ose mospermbushja e detyrimeve sipas kësaj Kontrate.

Një kopje e aktit të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i Autoritetit Kontraktues të jepet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit perkates. Në rast vonesë për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë kerkohet që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të pakten:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "shoqëri anonime", duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- ii. Objekti i shoqërisë: Ndertimi, operimi dhe transferimi i kaskadës së hidrocentraleve në lumin Shale, tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndertimi, venia në punë, prodhimi, furnizimi,

transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike, ne zbatim te kesaj Kontrate Koncesioni. (Nuk lejohet asnje lloj tjetër veprimtarie tregtare perveç atyre qe ushtrohen ne kuader te kesaj Kontrate);

iii. Kohezgjitja: Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me Periudhen e Koncesionit te kesaj Kontrate Koncesioni;

iv. Themeluesi i shoqerise: Shoqeria e re do te themelohet nga Koncesionari.

8.2. Te paraqese prane Autoritetit Kontraktues, per miratim Projektin e Zbatimit:

(i) Per hidrocentralet me derivacion: brenda 12 muajve nga Data Efektive.

(ii) Per hidrocentralin me dige dhe liqen per grumbullimin e ujit: brenda 24 muajve nga Data Efektive.

8.3. Te marre te gjitha lejet dhe licensat e nevojshme per realizimin e kesaj Kontrate ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi brenda 60 diteve pas perfundimit te periudhes 12 dhe 24 mujore te percaktuar ne nenin 8.2.

8.4. Te zbatoje projektin e zbatimit sipas percaktimeve te kesaj Kontrate;

8.5. Te marre masa qe çdo investim te behet sipas afateve te percaktuar dhe me cilesine e kerkuar ne kete Kontrate;

8.6. Te zbatoje projektin per ndertimin e kaskades se hidrocentraleve ne lumin Shale, me kapacitet totale te instaluar jo me pak se 127.600 kW; Koncesionari do te ndertoje me shpenzimet e tij linjen e transmetimit qe do te lidhe Hidrocentralet me rrjetin e OST dhe do te jete pergjegjes per kryerjen e te gjitha Punimeve. Pas perfundimit te Punimeve, linjat e transmetimit do te jene ne pronesi te OST dhe qe nga momenti i transferimit te pronesise, OST i transferohen te gjitha pergjegjesite dhe kostot per linjat e transferimit.

8.7. Te administroje Projektin per Periudhen e Koncesionit;

- 8.8. Te kerkoje nese e gjykon me interes dhe te pershtatshme, zbatimin e detyrimit te Autoritetit Kontraktues sipas pikes 5 te nenit 7, me siper;
- 8.9. Te ndermarre te gjitha masat e nevojshme per parandalimin dhe kontrollin ne lidhje me çdo ndotje mjedisore te shkaktuar nga ndonje punim i tij;
- 8.10. Te perballoje te gjitha shpenzimet qe lidhen me demet qe eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo paleve te treta, per Faj te Koncesionarit;
- 8.11. Te mbaje te informuar Autoritetin Kontraktues per çdo rrethane qe mund te kete ndikim ne ecurine e Projektit;
- 8.12. Te marre masa per te garantuar respektimin e dispozitave te Kodit te Punes dhe rregulloreve perkatese te sigurimit teknik, te disiplines teknike, te mbrojtjes ne pune, te higjenes dhe sigurimit nga zjarri, per te parandaluar çdo dem e fatkeqesi ne pune;
- 8.13. Koncesionari nuk duhet te nderhyje ne burimet ujore qe furnizojne ujesjellesin e zones;
- 8.14. Koncesionari duhet te marre masa per zbatimin e detyrimeve qe rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit ne fuqi per ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe te sasise se ujit ekologjik ne shtratin paresor te burimit ujqor te lumit Shale ne perputhje me rregullat ligjore ne fuqi;
- 8.15. Koncesionari duhet te siguroje ujin e nevojshem per vaditje, ne perputhje me nevojat e bujqesise dhe legjislacionin ne fuqi per rezervat ujore;
- 8.16. Ne veprimtarine e tij te zbatoje legjislacionin shqiptar ne fuqi;
- 8.17. Koncesionari ka te drejte, kundrejt zgjedhjes se tij, te kryeje transaksione me pale te treta dhe te shese pjesen e tij te energjise elektrike te prodhuar nga hidrocentralet, duke perfshire edhe transaksionet qe kane per qellim marrjen e çertifikatave te gjelberta apo ndonje nxitje tjeter ekuivalente, qe ka te beje me prodhimet e energjive te rinovueshme dhe veçanerisht ne lidhje me Mekanizmat e Zhvillimit te Pastertise (*Clean Development*

Mechanism) ne kuadrin e Protokollit te Kyoto, duke patur parasysh parashikimin e pikes 8 te ketij neni;

- 8.18. Ne kuader te zbatimit te punimeve per realizimin e Projektit, bazuar ne ligjin nr. 8402, date 10.9.1998, "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" dhe Udhezimit te Keshillit te Ministrave nr. 3, date 15.2.2001, "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", Koncesionari eshte i detyruar te emeruje nje subjekt ne rolin e mbikqyresit te punimeve. Ai mund te jete person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencen perkatese per ushtrimin e kesaj veprimtarie;
- 8.19. Te paguaje te gjitha shpenzimet per publikimet e bera, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9

Vleresimi i Investimeve

- 9.1. Duke u bazuar mbi te dhenat e Projektit, investimet qe duhet te kryhen nga Koncesionari jane ne vleren totale 144.606.305 (njqind e dyzet e kater milion e gjashte qind e gjashte mije e treqind e pese) Euro, nga te cilat 64.110.487 Euro (gjashtedhjete e kater milion e njqind e dhjete mije e katerqind e tetedhjete e shtate) do te investohen ne makineri e pajisje, sipas Aneksit nr. 1 (oferta e Koncesionarit).
- 9.2. Vleresimi i mesiper mund te pesoje ndryshime te mundshme, me marreveshje ndermjet paleve:
- pas variantit perfundimtar te Projektit te Zbatimit;
 - ne çdo kohe gjate zbatimit te projektit gjate ndertimit te hidrocentraleve.
- 9.3. Vlera e ndryshuar e investimit mund te jete me e madhe se 144.606.305(njqind e dyzet e kater milion e gjashteqind e gjashte mije e treqind e pese) Euro, por jo me e vogel se 137.375.990 Euro (njqind e tridhjete e shtate milion e treqind e shtatedhjete e pese mije e nenteqind e nentedhjete), qe perfaqeson nje ndryshim te investimit ne masen 5% (pese perqind) te investimit total te parashikuar.

Neni 10
Programi i punimeve

Koncesionari merr persiper te zbatoje programin e meposhtem kohor te punimeve:

10.1. Koncesionari merr persiper te filloje punimet per zbatimin e projektit brenda 60 ditesh nga perfundimi i periudhes 12 dhe 24 mujore te percaktuar ne nenin 8.2.

10.2. Koncesionari merr persiper te vere ne pune çdo hidrocentral brenda 28 (njetzet e tete) muajve ne perputhje me grafikun e punimeve te paraqitur ne Aneksin 2, bashkelidhur. Periudha prej 28 muajsh do te filloje nga data e perfundimit te periudhes 60-ditore te permendur ne nenin 8.3.

10.3. Keto afate do te ndryshohen dhe do te zgjaten nese ndodh:

(i) Rast i Forces Madhore (sipas percaktimeve te nenit 20);

(ii) Mospermbushje e detyrimeve te Autoritetit Kontraktues sipas kesaj Kontrate;

(iii) Vonese e autoriteteve shtetere ose publike, ne lidhje me leshimin e lejeve perkatese dhe te nevojshme per Koncesionarin me qellim permbushjen e detyrimeve sipas kesaj Kontrate;

(iv) Zbulim i relikave kulturore, arkeologjike, fosile, tuma varrezash dhe permendore, mbetje te kaluara artistike dhe çdo send tjetër me vlere arkeologjike, gjeologjike dhe historike ne vendndodhjen e Sheshit, qe rezulton ne kryerjen e puneve publike qe shkaktojne nderhyrje ne perfundimin e Punimeve nga Koncesionari; ose

(v) Marreveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nese marrja e lejeve nga institucionet perkatese eshte vonuar pertej kohes se rregullt proceduriale per leshimin e tyre, per arsye qe jane jashte kontrollit te Koncesionarit.

Koncesionari do te kete gjithashtu te drejten per kompensim te demeve te shkaktuara nga keto vonesa, duke perfshire edhe te drejtat qe rrjedhin nga Veprimet Shtetere Thelbesisht ne Kundershtim me Marreveshjen.

10.4. Koha e shtyrjes do te jete e barabrate me kohen e voneses se shkaktuar nga vonesa perkatese.

Neni 11
Testimi i vepres

- 11.1. Ne perfundim te punimeve, per secilin hidrocentral duhet te kryhet testimi, per te siguruar funksionimin e hidrocentraleve. Testimi do te filloje brenda 30 (tridhjetë) diteve nga marrja e njoftimit te bere nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 11.2. Ky testim do te kryhet nen mbikeqyrjen e nje grupi pune, ne perberje te te cilit do te kete perfaqesues te Autoritetit Kontraktues dhe te Koncesionarit, te cilet do te konkludojne me nje raport perfundimtar per venien ose jo ne pune te hidrocentralit, brenda 60 diteve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e Hidrocentraleve.
- 11.3. Ne rast mospjesemarrjeje te Autoritetit Kontraktues gjate testimit, Koncesionari ka te drejte te kryeje vete testimin dhe venien ne pune te vepres, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 diteve nga testimi dhe venia ne pune. Njoftimi me shkrim duhet te permbaje edhe rezultatet e testimit. Pas marrjes nga Autoriteti Kontraktues te ketij njoftimi, Autoriteti Kontraktues duhet te njoftoje me shkrim Koncesionarin brenda 30 diteve nga marrja e njoftimit, nese rezultatet e testimit jane te kenaqshme apo te pamjaftueshme sipas te dhenave dhe kerkesave teknike te percaktuara ne kete Kontrate. Testimi do te konsiderohet i pranuar ne menyre te kenaqshme ne rast mungese te njoftimit me shkrim.

Neni 12
Zgjidhja e Kontrates se Koncesionit

12.1. Zgjidhja e njeanshme e Kontrates nga Autoriteti Kontraktues.

- 12.1.1. Koncesionari nuk fillon punen per 6 muaj (per shkak te veprimeve apo mosveprimeve te tij) nga data e marrjes se lejes se ndertimit sipas nenit 10.1. Ne kete rast, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te marre vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.
- 12.1.2. Ne rast te mosrealizimit te fuqise se instaluar per me shume se 10 perqind te fuqise se instaluar sipas projektit te propozuar nga Koncesionari;

- 12.1.3. Kur Koncesionari transferon aksionet/kuotat e Shoqerise se re koncesionare, pa miratim te Autoritetit Kontraktues.
- 12.1.4. Kur Koncesionari braktis punimet e zbatimit per me shume se 100 (njqind) dite te njepasnjeshme. Ne kete rast Autoriteti Kontraktues ka te drejte te marre vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.
- 12.1.5. Kur shoqeria e re koncesionare eshte ne proqes falimentimi dhe/ose likuidimi, per Faj te Koncesionarit. Nese eshte e aplikueshme, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te marre vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.
- 12.1.6. Ne rast te realizimit te nje Vlere Investimi me te vogel sesa shuma prej 137.375.990 Euro (njqind e tridhjte e shtate milion treqind e shtatedhjte e pese mije nenteqind e nentedhjte), e cila perfaqeson nje ndryshim te investimit ne masen 5% (pese perqind) te vleres totale te investimit te parashikuar.
- 12.1.7. Kur Koncesionari nuk zbaton ne menyre te perseritur nje/disa nga detyrimet e tij te parashikuara ne kete Kontrate, qe perbejne nje ose disa shkelje thelbesore te kesaj Kontrate. Zgjidhja e njeanshme e Kontrates nuk qliron Koncesionarin nga detyrimi per te vazhduar zbatimin e Kontrates deri ne momentin e dorezimit te hidrocentraleve tek Autoriteti Kontraktues. Palet bien dakord qe dorezimi do te behet brenda nje afati kohor prej 60 ditesh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.

Nese ky detyrim nuk permbushet nga Konqesionari, atehere Autoriteti Kontraktues, ka te drejte te korrigoje ose te perpiqet te korrigoje mospermbushjen e detyrimit duke:

- (i) angazhuar nje pale te trete per te korrigjuar mospermbushjen, vonesat ose mungesat qe perbejne Rrethana te Mospermbushjes se Koncesionarit ose duke i kryer sa me siper vete;
- (ii) i faturuar Koncesionarit te gjitha shpenzimet dhe kostot e kryera realisht dhe te justifikuara ne menyre te arsyeshme qe lidhen me masat e ndermarra (si ne rastin kur ato jane ndermarre nga pale te treta apo jane ndermarre nga vete Autoriteti Kontraktues); dhe

(iii) terhequr nga Sigurimi i Kontrates çdo shume te percaktuar ne paragrafin (ii) me siper dhe qe jane ende te detyrueshme per t'u paguar edhe pas 30 (tridhjetë) diteve nga njoftimi me shkrim drejtuar Koncesionarit ne te cilen do te kerkohet pagesa ne lidhje me sa me siper (dhe per te shmangur çdo keqkuptim, Koncesionari do te kryeje pagesen e ketyre shumave drejtperdrejte tek Autoriteti Kontraktues ne rast se vlera e shumës ne fjale tejkalon vleren e shumës se Sigurimit te Kontrates).

12.1.8 Ne rast se Koncesionari nuk siguron Instrumentat Financiare (financimin) per projektin brenda 12 muajve nga data e hyrjes ne fuqi te kesaj Kontrate.

12.2. Zgjidhja e njeanshme e Kontrates nga Koncesionari;

Koncesionari ka te drejte te zgjidhe kete Kontrate kur Autoriteti Kontraktues eshte ne shkelje serioze te detyrimeve te tij kontraktore (duke perfshire edhe Veprimet Shteterore Thelbesisht ne Kundershtim me Marreveshjen) dhe nuk e korrigjon kete shkelje, brenda afatit te percaktuar ne piken 12.4 te ketij neni. Ne kete rast, Koncesionari ka te drejte te terheqe mbrapsht Sigurimin e Kontrates.

12.3. Zgjidhja e Kontrates nga secila pale

Secila nga palet ka te drejte te zgjidhe Kontraten kur:

12.3.1. Ndodhin Veprime Shteterore Thelbesisht ne Kundershtim me Marreveshjen.

12.3.2. Megjithe plotesimin e kriterëve per aplikim per leje, licenca nga ana e Koncesionarit dhe nderhyrjen e Autoritetit Kontraktues, Koncesionari nuk eshte pajisur me keto leje per fillimin e punimeve dhe/ose venien ne pune te Projektit.

12.3.3. Ndodhin rastet e parashikuara nga neni 20 pika 20.3 e kesaj Kontrate.

12.4. Njoftimi i zgjidhjes se Kontrates

Secila nga Palet qe kerkon zgjidhjen e kesaj Kontrate ne perputhje me kete nen, do te njoftoje paraprakisht me shkrim Palen tjeter. Njoftimi duhet te permbaje:

i. Detajet e duhura duke nenvizuar shkakun e zgjidhjes;

- ii. Daten e perfundimit te Kontrates, ne rast te moskorrigjimit te shkeljes brenda 30 diteve nga data e njoftimit ose brenda afateve te tjera te percaktuara me marreveshje midis Paleve;
- iii. Detaje te llogaritjes se pagesave si rezultat i zgjidhjes se Kontrates;
- iv. Çdo informacion tjetër te rendesishem.

12.5. Zgjidhja e Kontrates me marreveshje te Paleve

Palet kane te drejte ta zgjidhin Kontraten e koncesionit me pelqim te dyanshem, duke negociuar menyren e kompensimit te investimit. Ne çdo rast, Koncesionari ka te drejte te terheqe mbrapsht Sigurimin e Kontrates.

12.6. Te Drejtat e Paleve Financuese dhe zevendesimi i Koncesionarit:

12.6.1. Njoftimi i Paleve Financuese

Menjehere pas marrjes dijeni per shkelje serioze nga ana e Koncesionarit te detyrimeve kontraktore, qe cenojne zbatimin dhe operimin e Koncesionit ose sjellin si pasoje zgjidhjen e Kontrates sipas pikave 12.1.2, 12.1.3, 12.1.4, 12.1.5, 12.1.6 dhe 12.1.7 te nenit 12 te kesaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues perveç njoftimit te Koncesionarit sipas pikes 12.4 te ketij neni, njofton edhe Palen Financuese me qellim dhenien e nje mundesie, kesaj te fundit, per te ndihmuar Koncesionarin per te korrigjuar ose marre masa per te rregulluar keto shkelje brenda 30 (tridhjetë) ditesh nga data e nje njoftimi te tille ose brenda nje periudhe tjetër sipas marreveshjes se paleve. Autoriteti Kontraktues i jep Pales Financuese ndihmese te arsyeshme per kete qellim.

12.6.2. Zevendesimi i Koncesionarit

Ne rast se nuk eshte bere i mundur korrigjimi i shkeljes nga Koncesionari, Pala Financuese (nese e gjykon me interes) zgjedh te nderhyje duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit ne duart e nje subjekti zevendesues i cili duhet qe te kete ekspertizen, aftesite, reputacionin dhe gjendjen financiare te pakten te barazvlershme me ate te Koncesionarit, por gjithsesi ky transferim do te zgjase per nje periudhe qe nuk do te kaloje afatin prej 12 muajsh;

Ne lidhje me sa me siper, Autoriteti Kontraktues nuk do te pengoje apo vonoje pa arsye, pelqimin e tij dhe do te beje ato veprime qe kerkohen ose jane te dobishme per te realizuar kete transferim te drejtash ne lidhje me Palet Kontraktuese.

Subjekti zevendesues, do te kete te drejten e menaxhimit/administrimit te projektit dhe do te realizoje te gjitha te drejatat dhe detyrimet e Koncesionarit, por nuk do te kete te drejte te shese, te transferoje, te vendose hipoteke, peng apo barra siguruese mbi Hidrocentralet.

12.6.3. Nese Pala Financuese vendos te mos ushtroje te drejtat e parashikuara ne kete nen, ose nese edhe pas ushtrimit te ketyre te drejtave nuk arrihet ne nje zgjidhje te arsyeshme per vashdimesine e projektit, Kontrata do te zgjidhet.

12.7. Pagesat ne rast zgjidhjeje te Kontrates:

12.7.1 **Zgjidhja e Kontrates nga Autoriteti Kontraktues per faj te Koncesionarit.** Ne kete rast, Autoriteti Kontraktues do t'i paguaje Koncesionarit shumat e papaguara (duke perfshire por pa u kufizuar vetem tek kostot e parapaguara, shpenzime qe lidhen me zgjidhjen e Kontrates ose shpenzime te tjera duke perfshire edhe rastet e procedurave te pershpejtuara) sipas Dokumenteve Financiare deri ne masen e investimit ose te angazhimit per investim (te cilat jane dokumentuar rregullisht) per realizimin e projektit.

12.7.2. **Zgjidhja e Kontrates nga Koncesionari per faj te Autoritetit Kontraktues ose Veprime Shteterore Thelbesisht ne Kundershtim me Marreveshjen.** Ne kete rast, Autoriteti Kontraktues do t'i paguaje Koncesionarit **(i)** shumat e papaguara (duke perfshire por pa u kufizuar vetem tek kostot e parapaguara, shpenzime dhe tarifa qe lidhen me zgjidhjen e Kontrates ose shpenzime te tjera te pagueshme duke perfshire edhe rastin e procedurave te pershpejtuara) sipas Dokumenteve Financiare deri ne masen e investimit ose te angazhimit per investim (te cilat jane dokumentuar rregullisht) per realizimin e projektit, **(ii)** shumen e kontribuar nga ortaket tek Shoqeria Koncesionare deri ne masen e investuar ose te angazhuar per t'u investuar (te cilat jane dokumentuar rregullisht) per realizimin e projektit, dhe **(iii)** (35 minus numrin e viteve te kaluara deri ne daten e Zgjidhjes) \times 0,6 \times (Kthimi Mesatar mbi shumen e kontribuar nga ortaket tek Shoqeria Koncesionare per periudhen prej 3 vitesh te njepasnjeshem qe i paraprin Zgjidhjes) \times (vlera mesatare e shumes se kontribuar nga ortaket tek Shoqeria Koncesionare per periudhen prej 3 vitesh te njepasnjeshem qe i paraprin Zgjidhjes me kusht qe duke filluar nga Data Efektive deri ne fund te vitit te trete te

plote te Fazes se Operimit, vlera e shumes se kontribuar nga ortaket tek Shoqeria Koncesionare do te jete e barabarte me vleren ne fund te vitit te fundit qe i paraprin Zgjidhjes).

- 12.7.3. **Zgjidhja e Kontrates per shkak te Forces Madhore te zgjatur (nga secila prej paleve).** Ne kete rast, Autoriteti Kontraktues do t'i paguaje Koncesionarit (i) shumat e papaguara (duke perfshire por pa u kufizuar vetem tek kostot e parapaguara, shpenzime dhe tarifa qe lidhen me zgjidhjen e Kontrates ose shpenzime te tjera te pagueshme duke perfshire edhe rastin e procedurave te pershpejtuara) sipas Dokumenteve Financiare deri ne masen e investimit ose te angazhimit per investim (te cilat jane dokumentuar rregullisht) per realizimin e projektit, (ii) shumen e kontribuar nga ortaket tek Shoqeria Koncesionare deri ne masen e investuar ose te angazhuar per t'u investuar (te cilat jane dokumentuar rregullisht) per realizimin e projektit.

Neni 13
Kontratat

- 13.1 Koncesionari ka te drejte te lidhe kontrata me nenkontraktore(t) me qellim ushtrimin e disa prej te drejtave koncesionare, pas marrjes se miratimit paraprak te Autoritetit Kontraktues, i cili nuk do te refuzohet apo te vonohet ne menyre te paarsyeshme nese nenkontraktori i propozuar zoteron aftesite, reputacionin dhe burimet e mjaftueshme sipas rrethanave per te marre persiper keto detyrime (dhe çdo marreveshje nenkontraktore e lidhur nga Koncesionari pa kete miratim te Autoritetit Kontraktues do te konsiderohet se eshte nje Rast Mospermbushjeje nga Koncesionari), me kusht qe, sidoqofte, miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktues nuk do te kerkohet ne lidhje me (i) asnje nenkontraktor te njohur ne rang nderkombetar me reputacion te mire dhe (ii) asnje marreveshje nenkontraktore, vlera e te ciles (ne baza individuale ose permbledhese nese disa nenkontraktore jane te lidhur ne thelb me te njejtin transaksion) eshte me e vogel se 500.000 Euro (peseqind mije) dhe (iii) miratimi paraprak nga ana e Autoritetit Kontraktues do te lidhet vetem me identitetin e nenkontraktoreve, pa prekur kushtet dhe afatet e ketyre kontratave. Per menjanimin e ndonje keqkuptimi, furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dergesave nuk do te konsiderohen nenkontraktore sipas kesaj Kontrate.

- 13.2 Koncesionari eshte pergjegjes perpara Autoritetit Kontraktues individualisht dhe solidarisht me nenkontraktuesin, per permbushjen e detyrimeve nga ana e nenkontraktuesit.
- 13.3 Autoriteti Kontraktues nuk merr persiper asnje detyrim kundrejt sipermarresve, furnizuesve dhe te treteve, ne rast te mosmarreshjeve qe mund te lindin ndermjet nenkontraktoreve dhe Koncesionarit.

Neni 14

Sigurimi i Kontrates

- 14.1. Perpara nenshkrimt te kesaj Kontrate, Koncesionari duhet te kete ngurtesuar ne nje institucion bankar ose shoqeri sigurimesh, brenda territorit te Republikes se Shqiperise, ose te jape nje garanci bankare menjehere te kerkueshme te leshuar nga nje banke e njohur nderkombetare dhe me reputacion qe preferohet te kete aktivitet edhe ne Shqiperi (nepermjet nje filiali ose dege), ne favor te Autoritetit Kontraktues, ne nje shume prej 7.230.315 Euro (shtate milion e dyqind e tridhete mije e treqind e pesembedhete), qe perben 5% te vleres totale te Investimit.
- 14.2. Koncesionarit i lejohet te çngurtesoje kete shume, bazuar ne parashikimet e nenit 11, pas nje periudhe prej 30 (tridhete) ditesh nga kryerja e testimit dhe venia ne pune e Hidrocentraleve.
- 14.3. Sigurimi i Kontrates do te sherbeje per te garantuar zbatimin e detyrimeve te Koncesionarit ne lidhje me perfundimin e punimeve te ndertimit dhe perfundimin e testimit, ne menyren e duhur dhe brenda afatit te parashikuar.

Neni 15

Sigurimet

Koncesionari ne çdo kohe do te pajiset, mbaje dhe ripertesije ato garanci sigurimi te kerkuara ne lidhje me ushtrimin e te drejtave koncesionare dhe perdorimin e Sheshit ne perputhje me Praktiken e Industrise se Mire dhe do t'i dorezoje ose do te kujdeset qe t'i dorezohen Autoritetit Kontraktues kopjet e njehsuara me origjinalin te çdo çertifikate sigurimi pas marrjes se nje njoftimi te arsyeshem paraprak prej Autoritetit.

Pajisja me garancite e sigurimit sipas percaktimeve te ketij neni do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 16

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

16.1 Tarifa koncesionare

Koncesionari do te paguaje per llogari te Autoritetit Kontraktues nje tarife koncesionare te barabarte me vleren e 7 (shtate) perqind te prodhimit vjetor te energjise elektrike si dhe te çdo perfitimi tjeter qe Koncesionari do te kete nga prodhimi i kesaj energjie elektrike, duke perfshire por pa u limituar ne te drejtat qe rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave te tjere ne atmosfere. Ky perfitim do te jete ne raport te drejte me perqindjen qe perfaqeson tarifen koncesionare.

Kjo tarife nuk do te jete objekt ndryshimesh deri ne perfundim te kohezgjatjes se Kontrates se koncesionit.

Tarifa koncesionare do te perfshije edhe tarifen e perdorimit te ujit, ne masen dhe per periudhen qe do te jete ne fuqi ne perputhje me ligjin e zbatueshem shqiptar dhe kjo tarife e perdorimit te ujit perben pjese te tarifes koncesionare dhe do te konsiderohet e paguar me pagesen e tarifes koncesionare. Çdo rritje ose rivendosje e mevonshme e tarifes se perdorimit te ujit nuk do t'i jape te drejte Autoritetit Kontraktues per nje rritje korresponduese te shumes se tarifes se koncesionit ose anasjelltas.

Koncesionari detyrohet t'i jape Autoritetit Kontraktues tarifen koncesionare ne natyre – duke i furnizuar sasine prej 7 % te prodhimit vjetor neto te energjise elektrike, pa pagese. Tarifa koncesionare do te jepet nga Koncesionari dhe do te merret ne dorezim nga KESH ose OST ne emer te Autoritetit Kontraktues, ne Piken e Levrimit.

Koncesionari nuk do te mbaje asnje pergjegjesi ne lidhje me detyrimet per pagese te tarifes koncesionare ne rast se energjia elektrike e furnizuar nuk do te merret ne dorezim nga KESH ose OST ne emer te Autoritetit Kontraktues.

16.2 Vlera e riinvestimit

Gjate periudhes qe fillon nga viti i 15-te i hyrjes ne fuqi te kesaj Kontrate dhe deri ne perfundim te Periudhes Koncesionare, Konçesionari do te riinvestoje 100 (njqind) % te vleres se investimit per makineri dhe pajisje, sipas nje grafiku qe do te hartohet nga palet per kete qellim. Kjo vlere do te aktualizohet sipas indeksit te inflacionit.

Neni 17 **Kufizimet**

17.1 Gjate Periudhes se Koncesionit, Koncesionari do te kontrolloje Shoqerine Koncesionare me kusht qe pavaresisht nga kjo dispozite, (i) çdo ortak (duke perfshire edhe Koncesionarin) do te kete te drejte te transferoje lirisht, pjeserisht ose teresisht kuotat e Shoqerise se re Koncesionare kundrejt nje ortaku tjeter ose ndonje prej Filialeve te tij ne çdo kohe gjate Periudhes se Koncesionit, me kusht qe ky transferim te mos sjelle transferimin e kontrollit nga Koncesionari, si dhe (ii) çdo transferim tjeter, i pjesshem ose i plote, i kuotave te Shoqerise Koncesionare (duke perfshire transferimin e Kontrollit) do te jete objekt i miratimit paraprak te Autoritetit Kontraktues, miratim i cili nuk do te refuzohet ose vonohet ne menyre te paarsyeshme; me kusht qe ne lidhje me ndonje transferim te propozuar ne perputhje me piken (ii) me siper (duke perfshire transferimin e Kontrollit), Autoriteti Kontraktues do t'i kushtoje konsideraten e duhur eksperiences, gjendjes financiare (e cila do te perfshije mbeshtetjen kredituese nga pale te treta), stabilitetit dhe reputacionit te perfituesit te transferimit te propozuar.

17.2 Shoqeria e re qe do te krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Koncesionari ka te drejte te vendose hipoteke, peng, apo ndonje barre tjeter mbi asetet qe do te krijohen ne zbatim te projektit te punimeve si dhe te lidhe çdo lloj marreveshje financimi me çdo Pale Financuese, me kusht qe hipoteka, pengu apo barra tjeter si dhe marreveshja perkatese e financimit t'i sherbeje permbushjes se detyrimeve te Koncesionarit ne kete Kontrate.

Neni 18
Raportimi

18.1 Duke filluar nga Data Efektive, Koncesionari eshte i detyruar qe çdo tre (3) muaj te raportoje me shkrim prane Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit te investimeve ne vlore dhe ne natyre dhe me pas sasine e prodhimit te energjise elektrike, si dhe çdo informacion tjeter qe do te konsiderohet i nevojshem nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19
Legjislacioni i zbatueshem

19.1. Zbatimi dhe interpretimi i kesaj Kontrate Koncesioni do te bazohet ne legjislacionin shqiptar.

Neni 20
Forca Madhore

20.1 Rast i Forces Madhore do te thote çdo rrethane qe nuk eshte ne menyre te arsyeshme ne kontroll te pales qe pretendon Rastin e Forces Madhore, qe nuk mund te parandalohet ose shmangej ne menyre te arsyeshme dhe qe si rezultat i te ciles pala qe pretendon Rastin e Forces Madhore e ka te pamundur qe te permbushet nje ose disa prej detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate, duke perfshire por pa u kufizuar rastet ne vijim:

- i. Katastrofat e natyres, permbytjet, termetet, ndotje nukleare, kimike, biologjike dhe çdo ngjarje e barabarte me to;
- ii. Lufta, lufta civile, konflikte te armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo- qe zgjasin per nje kohe jo me te vogel se nje muaj;

20.2. Ne rastet e Forces Madhore pala e demtuar duhet te njoftoje palen tjeter brenda 30 diteve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e permbushjes se detyrimeve ne menyre qe te gjejne nje rruge per te lehtesuar efektet e forces madhore dhe te vazhdojne Kontraten.

Vonesat ne permbushjen e detyrimeve si rrjedhoje e ngjarjeve te Forces Madhore, mund te jene shkak per kerkesa reciproke per demshperblim apo per permbushje te detyrimeve kontraktore. Kufijte e permbushjes se detyrimeve do te percaktohen nga palet ne marreveshje ndermjet tyre.

Periudha e Koncesionit do te zgjatet ne perputhje me nenin 4.2.3 te kesaj Kontrate.

20.3. Zgjidhja e Kontrates per shkak te forces madhore

Kontrata do te zgjidhet kur:

- i. ne rast se edhe pas zbatimit te pikes 20.2 te ketij neni, nuk eshte arritur nje zgjidhje ne te mire te projektit,
- ii. nese Rasti i Forces Madhore zgjat me teper se 6 muaj pa nderprerje.

20.4. Pasojat e zgjidhjes se Kontrates per shkak te forces madhore

Ne rastet e zgjidhjes se Kontrates per shkak te Forces Madhore, Autoriteti Kontraktues do t'i paguaje Koncesionarit:

(i) kompensim qe i korrespondon çdo shume te papaguar (duke perfshire por pa u kufizuar vetem tek parapagimet e kostove, demet e terthorta, shpenzime te tjera qe lidhen me zgjidhjen e Kontrates ose shpenzime te tjera duke perfshire edhe rastet e procedurave te pershpejtuara) sipas Dokumenteve Financiare ne masen e investimit ose te angazhimit te investimit (te cilat jane dokumentuar rregullisht) per realizimin e Projektit.

(ii) shumen e kontribuar nga ortaket ne Shoqerine Koncesionare ne masen e investimeve te kryera ose te angazhimeve te investimeve (te cilat jane dokumentuar rregullisht) per realizimin e Projektit (minus te ardhurat e sigurimit qe do te zvogelojne çdo shume te papaguar sipas Instrumenteve Financiare).

20.5. Zgjidhja e mosmarreshje qe vijne si pasoje e Forces Madhore do te behet ne perputhje me nenin 22 te kesaj Kontrate.

Neni 21

Hyrja ne fuqi e Kontrates se Koncesionit

21.1. Kontrata e Koncesionit hyn ne fuqi pasi Vendimi i Keshillit te Ministrave qe miraton kete Kontrate te jete efektiv, ne perputhje me Ligjin nr. 9663, date 18.12.2006 "Per koncesionet" (te ndryshuar) ("Data Efektive").

Neni 22

Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

22.1. Zgjidhja me Pajtim

Nese do te linde ndonje mosmarreveshje nga kjo Kontrate ose ne lidhje me te ("Mosmarreveshja"), secila nga palet do t'i jape pales tjetër njoftim ne lidhje me kete mosmarreveshje, pas se cilit Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do te takohen menjehere dhe do te perpiqen me mirebesim te arrijne nje zgjidhje me pajtim.

22.2. Eksperti Teknik dhe Ekonomik

22.2.1 Mosarritja e zgjidhjes me pajtim

Nese nuk arrihet nje zgjidhje me pajtim ne perputhje me nenin 22.1 brenda 30 (tridhete) diteve nga marrja e njoftimit te parashikuar me siper, mosmarreveshjet do t'i paraqiten nje eksperti ("Eksperti Teknik dhe Ekonomik").

22.2.2 Perzgjedhja e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik

Ne menyre qe te caktohet Eksperti Teknik dhe Ekonomik, (i) Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do te caktojne secili nje (1) ekspert brenda 15 (pesembedhete) ditesh pas perfundimit te periudhes se siperpermendur per zgjidhjen me pajtim dhe (ii) ekspertet respektive se bashku do te caktojne Ekspertin Teknik dhe Ekonomik sa me shpejt qe te jete e mundur.

22.2.3 Fuqia ligjore e vendimeve te Ekspertit Teknik dhe Ekonomik

Me perjashtim te rastit kur parashikohet shprehimisht ndryshe ne kete Kontrate, vendimet e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik do te kene vetem vleren e rekomandimeve per Autoritetin Kontraktues dhe Koncesionarin dhe nuk do te perbejne vendime detyruese per ta, duke perfshire edhe vendimet per qellimet e procedurave te arbitrazhit siç parashikohet ne nenin 22.3 me poshte.

22.3. Arbitrazhi

Nese nje mosmarreveshje nuk eshte zgjidhur mes paleve nepermjet zgjidhjes me pajtim ose nepermjet Ekspertit Teknik dhe Ekonomik, mosmarreveshja mund t'i paraqitet arbitrazhit nderkombetar siç parashikohet me poshte.

Kontrata, te drejtat dhe detyrimet e paleve sipas kesaj Kontrate do te mbeten ne fuqi dhe do te kene efekt deri ne daljen e nje vendimi nga nje proces i tille arbitrazhi, vendim i cili, nese eshte e mundur, do te percaktoje nese dhe kur do te hyje ne fuqi zgjidhja e Kontrates.

Te gjitha procedurat e arbitrazhit lidhur me sa me siper do te kryhen ne Paris, France dhe do te zhvillohen ne perputhje me Rregullat e Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise (ICC) ne prani te nje paneli prej tre (3) arbitrash te caktuar ne perputhje me keto Rregulla.

Arbitrazhi do te zhvillohet ne gjuhen angleze dhe dokumentet qe do te paraqiten ne lidhje me kete procedure do te jene ne gjuhen angleze ose te shoqeruara me nje perkthim te vertetuar ne gjuhen angleze.

Neni 23 **Sanksionet**

23.1. Ne rast se Koncesionari nuk respekton afatet dhe kushtet e kesaj Kontrate ne perfundim te periudhes te parashikuar ne nenin 10 te kesaj Kontrate, Koncesionari do te paguaje penalitetet e meposhtme:

- i. Per mosrespektim te afatit te ndertimit, Koncesionari do te paguaje 0.02 % ne dite te vleres se investimeve te munguara.

- ii. Per moskryerje te investimeve ne vleren 144.606.305 Euro (njqind e dyzete e kater milion e gjashteqind e gjashte mije e treqind e pese), siç eshte rene dakord sipas nenit 9.3, Koncesionari do te paguaje 10 % te differences midis vleres se investimeve te rene dakord prej 144.606.305 Euro (njqind e dyzete e kater milion e gjashteqind e gjashte mije e treqind e pese), minus vleren e investimeve te kryera realisht nga Koncesionari.
- iii. Per çdo dite vonese per fillimin e punimeve, Koncesionari do te paguaje shumen 77 Euro (shtatedhjete e shtate).

Keto penalitete do te mbahen dhe zbriten nga Sigurimi i Kontrates parashikuar ne nenin 14 me siper, duke patur parasysh se nese vlera e ketij sigurimi nuk eshte mjaftueshme per shlyerjen e penaliteteteve, Koncesionari do te paguaje diferencen, rast pas rasti.

23.2. Ne rast mosrealizimi te prodhimit te energjise elektrike dhe fuqise se vendosur sipas kushteve te rena dakord ne kete Kontrate, Koncesionari do te paguaje penalitetet e meposhtme:

- i. Ne rast mosrealizimi te prodhimit te energjise elektrike prej 530.350.000 KWh/vit per Faj te Koncesionarit, Koncesionari duhet te paguaje 5 % te vleres se prodhimit te pa realizuar per periudhen raportuese, duke patur parasysh se ne kete rast Autoriteti Kontraktues do ta marre te plote tarifen koncesionare prej 7 % (per nje sasi prej 37.124.500 KWh/vit). Ne rast se prodhimi nuk realizohet per shkaqe te tjera, Koncesionari nuk penalizohet per prodhimin e munguar. Ne kete rast, Koncesionari eshte i detyruar te paguaje tarifen koncesionare ne vleren prej 7 % te prodhimit faktik te realizuar.
- ii. Per mosrealizim te fuqise se vendosur deri ne 10 %, percaktuar sipas nenit 3 te kesaj Kontrate, Koncesionari do te paguaje penalitetin e meposhtem:

Shuma e penalitetit = Prodhimi vjetor i energjise elektrike \times Fuqia e painstaluar (ne %) \times Vitet e operimit siç jane llogaritur ne oferte \times Çmimi i shitjes se energjise elektrike vendosur nga ERE ne momentin e kryerjes se testimit te vepres sipas nenit 11 te kesaj Kontrate \times Tarifa Koncesionare (ne %).

Ky penalitet do te aplikohet ne momentin e testimit te vepres ne perputhje me nenin 11 te kesaj Kontrate.

- 23.3. Palet bien dakord qe penalitetet e parashikuara ne paragrafet 23.2 do te zbatohen deri ne nje vlere prej 10 % te vleres se investimit. Penalitetet e percaktuara ne paragrafin 23.2.i do te llogariten çdo fund viti kalendarik, sipas nje akti rakordimi te perbashket qe behet ndermjet paleve te kesaj Kontrate, ndersa penalitetet e percaktuara ne paragrafin 23.2.ii do te llogariten si sanksione vetem per nje rast, pas venies ne pune se te gjitha Hidrocentraleve, sipas nje procesverbali te perbashket te perpiluar nga palet.
- 23.4. Ne rast se Koncesionari nuk paraqet projektin e zbatimit per miratim nga Autoriteti Kontraktues, brenda afateve te parashikuara ne nenin 8.2 te kesaj Kontrate, Koncesionari do te paguaje penalitet te barabarte me 0,005% te vleres se investimit per çdo dite vonese.
- 23.5. Penalitetet paguhen ne llogari te Autoritetit Kontraktues. Ne rast te konstatimit te shkeljeve qe çojne ne aplikimin e penaliteteve sipas ketij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do te diskutojne per nje periudhe 30 ditore lidhur me shkeljen.
- 23.6. Kur vendoset per aplikimin e penalitetit perkates, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta te kerkoje pagesen brenda 20 ditesh. Ne rast se Koncesionari nuk paguan ne kohe, Autoriteti Kontraktues ka te drejte qe se bashku me pagesen e detyrimit kryesor te kerkoje edhe kamatat ligjore.

Neni 24

Rregullimi i shkeljeve

- 24.1. Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjate Periudhes se Koncesionit, Koncesionari ka shkelur ndonje prej detyrimeve te percaktuara ne kete Kontrate, Autoriteti Kontraktues menjehere ia ben te njohura keto shkelje Koncesionarit. Koncesionari duhet te pergjigjet me argumentat perkatese brenda 40 diteve. Palet me marreveshje te perbashket do te percaktojne menyren dhe afatin brenda te cilit do te rregullohet shkelja.

24.2. Kjo procedure nuk e perjashton Koncesionarin nga detyrimi per te paguar demet qe rrjedhin nga mospermbushja e detyrimeve kontraktore, te cilat jane percaktuar ne kete Kontrate ose ne mungese te ketyre percaktimeve, siç eshte parashikuar nga dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar.

Neni 25 **Transferimi i Aseteve**

25.1. Me mbarimin e Kontrates sipas percaktimeve te nenit 26, Koncesionari do te kryeje çdo veprim te nevojshem per dorezimin tek Autoriteti Kontraktues te aseteve te marra ne dorezim nga ai ose ato te realizuara nga Koncesionari gjate Periudhes se Koncesionit si dhe çdo titull mbi to, te zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barre apo hipoteke.

Procesi i dorezimit do te fillohet te pakten 6 (gjashte) muaj perpara dates se mbarimit te Periudhes se Koncesionit me nje inspektim te perbashket te Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

Menjehere pas mbarimit te Periudhes se Koncesionit, Hidrocentralet duhet te jene ne nje gjendje te arsyeshme mirembajtjeje, pastertie dhe pamjeje, duke marre parasysh vjetersine dhe amortizimin e arsyeshem.

25.2. Koncesionari duhet te transferoje pa kundershperblim ne favor te Autoritetit Kontraktues:

- i. Hidrocentralin dhe objektet ekzistuese te lidhura me te;
- ii. ndertesat, makinerite, paisjet;
- iii. pronesine mbi ndertesat apo impiantet e ndertuara nga Koncesionari;
- iv. te drejtat kontraktore;
- v. librat, dokumentave dhe garancite qe shoqerojne keto asete;
- vi. çdo te drejte tjeter te fituar nga Koncesionari nepermjet kesaj Kontrate;

25.3. Koncesionari duhet te provoje se keto asete jane te mirembajtura dhe ne gjendje te mire pune, duke marre parasysh normen e amortizimit perkates.

Ne rast se Kontrata eshte zgjidhur per shkak te Forces Madhore, Koncesionari duhet te provoje se gjendja ekzistuese e aseteve ka ardhur si pasoje direkte e saj.

25.4 Çdo te drejte qe Koncesionari ka fituar me kete Kontrate do te mbaroje me transferimin e projektit.

25.5 Kostot e transferimit te projektit do te perballohen nga Koncesionari, pervec rastit kur zgjidhja e Kontrates ka ardhur per faj te Autoritetit Kontraktues.

Neni 26
Mbarimi i Kontrates

26.1. Kontrata koncesionare mbaron me perfundimin e Periudhes se Koncesionit prej 35 vjetesh, duke patur parasysh parashikimet e nenit 4 te kesaj Kontrate.

26.2. Mbarimi i Kontrates si rrjedhoje e perfundimit te Periudhes se Koncesionit ose te zgjidhjes se parakohshme nuk zhvesh asnje pale nga detyrimi per pagimin e detyrimeve te prapambetura ndaj pales tjetere dhe paleve te treta.

Neni 27
Konfidencialiteti

27.1. Secila nga palet duhet te konsideroje si konfidenciale te gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera ne lidhje me projektin, qofshin keto tregtare apo teknike dhe nuk duhet qe te gjithe apo nje pjese te dokumentit apo informacionit t'ja beje te ditur nje pale te trete, pa miratimin e pales tjetere, pervecse per qellimin e permbushjes se kushteve te kesaj Kontrate.

Neni 28
Ndryshime

28.1. Kjo Kontrate mund te pesoje ndryshime, shtesa dhe/ose zevendesime vetem me marreveshje me shkrim te dy paleve.

28.2. Çdo ndryshim i kesaj Kontrate apo anekseve bashkelidhur saj, pasi te hyje ne fuqi, do te jete pjese perberese dhe e pandashme e kesaj Kontrate.

Neni 29

Bashkepunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari jane zotuar te bashkepunojne ne menyre qe te garantojne realizimin e plote te projektit.

Çdo komunikim per çdo problem ndermjet paleve, do te behet vetem me shkrim, ne adresat e treguara me poshte nga palet. Palet jane te detyruara t'i njoftojne menjehere njera-tjetres çdo ndryshim te seciles prej ketyre te dhenave, brenda nje afati 10 (dhjete) ditor nga data e ndryshimit.

Per çdo ndihme qe do t'i kerkohet Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari, ky i fundit detyrohet te paraqese kerkesen me shkrim ne lidhje me çeshtjet qe kerkohen ne zbatim te detyrimeve te kesaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e kontaktit qe do te perdoren gjate zbatimit te kesaj Kontrate jane:

Per Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomise, Tregtise
dhe Energjitikes
Blvd. Zogu i Pare, Nr. 1001,
Tirane - Shqiperi

Per Koncesionarin

Shoqeria "INTERENERGO
ALBANIA" sh.p.k.
Adresa: "Deshmoret e Kombit"
Twin Towers (Kullat Binjake)
Kulla II, Kati 11
Tirane - Shqiperi
Tel: +355 42280158
Email:
nexhat.maliqi@interenergo.si

Neni 30

Regjistrimi i Kontrates

Kjo Kontrate duhet te regjistrohet ne regjistrin e pasurive te paluajtshme brenda 30 diteve nga miratimi i Projektit te Zbatimit.

KONTRATE KONCESIONI "BOT"

Kjo Kontrate u hartua ne 6 (gjashte) kopje, ne gjuhen shqipe dhe angleze. Ne rast te ndonje mosperputhjeje midis dy gjuheve, versioni shqip do te kete perparesi ndaj versionit anglisht.

PALET

AUTORITETI KONTRAKTUES

KONCESIONARI

Ministria e Ekonomise, Tregtise
dhe Energjetikes

Bashkimi i perkohshem i
shoqerive
"INTERENERGO"

Perfaqesuar nga :

Perfaqesuar nga:

Z. K

Z. Anfon rapca